



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 32 par.5 të Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 21 e datës 13.06.2013 si dhe nenit 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 Kuvendi i Komunës së Lipjanit, në mbledhjen e mbajtur me 29. 04. 2016, pas shqyrtimit të propozim Rregullores nga Kryetarit Komunës, miratoj këtë:

**RREGULLORE
PËR PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME
AUTOMJETE TAKSI 15NR.011-27942 TË DATËS 21.07.2014**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Qëllimi i miratimit të kësaj Rregulloreje është plotësimi i Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-27942 të datës 21.07.2014.

2. Neni 9 - Revokimi dhe marrja e Licencës plotësohet si vijon:

Pas paragrafit të 4 shtohet paragrafi i ri paragrafi 5 i cili përkufizohet si vijon:

“ Licenca do ti merret operatorit nëse dy vite radhazi nuk e paguan taksën vjetore për shfrytëzimin e autoparkut sipas Rregullores për taksa komunale”, ndërsa paragrafi 5 i këtij neni bëhet paragrafi 6 .

Procedurën për revokimin e licencës sipas këtij paragrafi e aplikon sipas detyrës zyrtare Drejtorati për Shërbime Publike.

**Neni 2
Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 011-22914
Lipjan, më 03. 05. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJANIT

**KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajruni**

